



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201500747/15

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda:** *Rekomandohet zbatimi i legjislacionit për vendosjen e të dënuarit nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë*

**Drejtuar:** **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**  
Z. Miklovan KOPANI

**TIRANË**

*I nderuar Z. Kopani,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i burgosuri A. T., i cili pretendon se është vendosur nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë në kundërshtim me ligjin.

Për verifikimin e kësaj ankese i jemi drejtuar fillimisht IEVP Elbasan. Në përgjigjen e këtij institucioni sqarohet se, A. T. është vendosur nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë për periudhën 11.03.2015 – 25.05.2015. Kjo masë është kërkuar nga Drejtori i Policisë së Burgjeve.

Më pas jemi interesuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ku kemi kërkuar të na dërgohej fotokopje e praktikës së ndjekur për këtë rast: dokument që provon se A. T. kishte kryer një nga veprimet e parashkuara në nenin 55, paragrafi i parë i Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998, urdhër për vendosjen e tij nën regjimin e mbykëqyrjes së veçantë, kërkesë të organit të prokurorisë dhe vendim të gjykatës. Në përgjigjen e DPBurgjeve u vumë në dijeni se, A. T. ishte vendosur nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë pas informacionit të marrë nga Policia e Shtetit, sipas të cilit ky i burgosur ishte drejtues i një grupi kriminal dhe jepte urdhëra për kryerjen e veprave të ndryshme penale. I vetmi dokument që na u vu në dispozicion ishte një kopje e email-it që Z. P. M. i dërgon IEVP Elbasan për marrjen e masave të sigurisë ndaj të burgosurit A. T. dhe vendosjen e tij nën mbikëqyrjen e veçantë. Bashkëlidhur kësaj shkresë do të gjeni fotokopjen e email-it, urdhërin e drejtorit të IEVP Elbasan për vendosjen e të dënuarit A. T. nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë dhe përgjigjen e DPBurgjeve.

Referuar nenit 55 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998, kur i dënuari vendoset nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë duhet të vihet në dijeni prokurori

si dhe duhet të kërkohet konfirmimi i gjykatës. Për rastin e të dënuarit A. T. nuk rezulton që të jetë njoftuar prokurori dhe të jetë dhënë vendim nga gjykata.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive."

### **J U R E K O M A N D O J M Ë:**

Zbatimin e legjislacionit për vendosjen e të dënuarit nën mbikqyrjen e regjimit të veçantë.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

*Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**